



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 19 janar 2012
Nr. ref.: RK186/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI 126/10

Parashtruesi

Lulzim Ramaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit të Ministrisë së Transportit dhe
Telekomunikacionit Nr. 140, të 25 janarit 2010**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Lulzim Ramaj, me vendbanim në Pejë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës, në mënyrë eksplicite, e konteston Vendimin e Ministrisë së Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit (në tekstin e mëtejme: MTPT) me Nr. 140, të 25 janarit 2010.
3. Mirëpo, në kërkesë parashtruesi i kërkesës po ashtu ankohet edhe ndaj dy procedurave, procedurës ndaj Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit dhe procedurës ndaj Postës dhe Telekomunikacionit në Pejë, pa specifikuar se në lidhje me çka janë ankesat e tij.

Objekti i çështjes

4. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i është shkelur e drejta e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 24 [Barazia para Ligjit].

Baza juridike

5. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 22 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës i 15 janarit 2009, (Nr. 03/L-121), (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Më 28 tetor 2010, parashtruesi i kërkesës e parashtroi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata). Të njëjtën ditë Sekretariati i Gjykatës e njoftoi parashtruesin e kërkesës se ai duhej të plotësonte formularin e kërkesës.
7. Më 9 nëntor 2010, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi formularin e kërkesës në Gjykatë.
8. Më 27 janar 2011, Gjykata ia komunikoi kërkesën MTPT-së, e cila deri më tani nuk ka dorëzuar asnjë dokument.
9. Më 4 shkurt 2011, parashtruesi i kërkesës dorëzoi dokumente shtesë.
10. Më 14 shkurt 2011, Kryetari, me Urdhrin Nr. GJR. 126/10, e emëroi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese. Të njëjtën datë, Kryetari, me Urdhrin Nr. KSH. 126/10, e emëroi Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.
11. Më 28 prill 2011, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të specifikonte se në çfarë mënyre vendimet e kontestuara ia cenonin të drejtat e garantuara me Kushtetutë.
12. Më 12 maj 2011, parashtruesi i kërkesës u përgjigj, mirëpo përgjigja e tij nuk kishte të bënte me kërkesën fillestare.
13. Më 29 nëntor 2011, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe ia paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 10 janar 2008, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Shërbimin Postar të Kosovës lidhur me vonesën e pranimit të letrave.
15. Më 21 dhjetor 2009, parashtruesi i kërkesës përsëri i shkroi Shërbimit Postar të Kosovës duke u ankuar rreth vonesave në shërbimin postar dhe rreth kontrollit të pretenduar të letrave nga ana stafit të Shërbimit Postar.
16. Më 5 janar 2010, parashtruesi i kërkesës u ankua në MTPT ndaj vendimit të Shërbimit Postar të Kosovës, të 24 dhjetorit 2009, me të cilin ishin hedhur poshtë pretendimet e tij.
17. Më 25 shkurt 2010, parashtruesi i kërkesës u ankua në Gjykatën Supreme ndaj vendimit të MTPT-së të 25 janarit 2010. Parashtruesi i kërkesës konsideronte se MTPT nuk i kishte marrë parasysh vërejtjet dhe ankesat e tij.
18. Më 27 korrik 2010, parashtruesi i kërkesës e parashtrroi një ankesë në Këshillin Gjyqësor të Kosovës ndaj Gjykatës Supreme për mosshqyrtimin e ankesës së tij të 25 shkurtit 2010 dhe për stërzgjatje të rastit.
19. Më 13 gusht 2010, Këshilli Gjyqësor i Kosovës lëshoi një vendim në lidhje me ankesën e parashtruesit të kërkesës të 27 korrikut 2010.
20. Më 25 gusht 2010, parashtruesi i kërkesës u ankua ndaj vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të 13 gushtit 2010 për mosndërmarrje të masave ligjore ndaj Gjykatës Supreme.
21. Sa i përket procedurave ndaj Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit dhe procedurave ndaj Postës dhe Telekomunikacionit në Pejë, faktet paraqiten si në vijim:

a) Faktet në lidhje me procedurat ndaj Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit

22. Më 31 mars 2009, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në MTPT në lidhje me vonesat e shërbimit postar, vjedhje dhe për mospastrim të vulës, gjë që e vështirëson leximin e datës në vulë.
23. Më 13 maj 2010, parashtruesi i kërkesës parashtrroi edhe një ankesë në MTPT në lidhje me vonesën e marrjes së postës.
24. Më 20 maj 2010, MTPT lëshoi një vendim të cilin parashtruesi i kërkesës nuk e ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese.
25. Parashtruesi i kërkesës pastaj parashtrroi ankesë në Gjykatën Supreme ndaj vendimit të MTPT-së, të 20 majit 2010.
26. Më 8 qershor 2010, parashtruesi i kërkesës parashtrroi parashtrësë në Gjykatën Supreme duke e ndryshuar ankesën ndaj vendimit të MTPT-së, të 20 majit 2010.
27. Më 11 qershor 2010, Gjykata Supreme i dërgoi njoftim parashtruesit të kërkesës për pagesën e një takse gjyqësore në lidhje me ankesën e tij në Gjykatën Supreme.
28. Më 19 qershor 2010, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi përgjigjen në njoftimin e Gjykatës Supreme të 11 qershorit 2010.

29. Më 17 korrik 2010, parashtruesi i kërkesës paraqiti parashtrësë në Gjykatën Supreme me të cilën e ndryshoi ankesën e tij.

b) Faktet në lidhje me procedurat ndaj Postës dhe Telekomunikacionit në Pejë

30. Më 29 prill 2010, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Postën e Pejës ndaj zyrtarëve të Shërbimit Postar të Kosovës për mosdërgimin në kohë të faturës së telefonit.
31. Më 7 korrik 2010, parashtruesi i kërkesës paraqiti edhe një ankesë në PTK-në e Pejës ndaj punëtorëve të PTK-së për pasurim të padrejtë dhe shpërdorim gjatë kryerjes së detyrës zyrtare.
32. Më 2 shtator 2010, parashtrroi edhe një ankesë në PTK-në e Pejës në lidhje me pretendimin për shpërdorim nga ana e punëtorëve të PTK-së, duke pohuar se për pullat postare që i kishte blerë i ishte dashur të paguajë më shumë se duhej paguar zakonisht dhe se punëtorët e tjerë të PTK-së nuk e kishin pastruar vulën para përdorimit.
33. Më 7 shtator 2010, parashtruesi i kërkesës parashtrroi ankesë në Gjykatën Supreme ndaj vendimit të Degës së PTK-së në Pejë, të 3 shtator 2010.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon se i është cenuar e drejta e garantuar me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.
35. Parashtruesi i kërkesës thekson se, me këtë kërkesë në Gjykatën Kushtetuese duhet t'i realizohen të drejtat e tij ashtu që, autoritetet: PTK, MTPT dhe dega e PTK-së në Pejë duhet t'i paguajnë kompensim monetar për dëmet që pretendon se ia kanë shkaktuar dhe se punëtorët e PTK-së duhet të mbahen përgjegjës për shpërdorim gjatë kryerjes së detyrave të tyre.

Vlerësim i pranueshmërisë së kërkesës

36. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se i është cenuar e drejta e garantuar me nenin 24 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës, Gjykata vëren se për të qenë në gjendje të gjykojë për ankesën e parashtruesit, së pari duhet të shqyrtojë nëse ai i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
37. Në lidhje me këtë, duhet përmendur nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 (2) të Ligjit, sipas të cilëve, individët që parashtrojnë kërkesë në Gjykatë duhet të tregojnë se i kanë shteruar të gjitha mjetet juridike që i kanë në dispozicion në bazë të ligjit të aplikueshëm.
38. Gjykata e thekson se arsyetimi për kërkesën e shterimit është që t'iu ofrojë autoriteteve përkatëse, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljet e pretenduara të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive juridike kundër shkeljes së të drejtave kushtetuese (shih *mutatis mutandis*, GJEDNJ Selmouni kundër Francës, nr. 25803194, vendimi i 28 korrikut 1999). Sidoqoftë, nuk është e domosdoshme që të drejtat kushtetuese të ngrihen në mënyrë eksplicite gjatë procedurave në fjalë. Derisa kjo çështje është ngritur në mënyrë implicite ose në substancë, kërkesa për shterimin e

mjeteve është plotësuar (shih, *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Azinas kundër Qipros, nr. 56679/00, Vendimi i 28 prillit 2004).

39. Kjo Gjykatë e ka përdorur të njëjtin arsyetim kur e ka nxjerrë Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin Universiteti AAB – RIINVEST SH. P. K. kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, rasti KI 41/09 i 27 janarit 2010, si dhe në Aktvendimin për Papranueshmëri në rastin Mimoza Kusari – Lila kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Rasti nr. 73/09 i 23 marsit 2010.
40. Sa i përket këtij rasti, nga parashtruesit të kërkesës është e qartë se procedurat ndaj Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit si dhe procedurat ndaj Postës dhe Telekomunikacionit në Pejë, ende nuk kanë përfunduar në Gjykatën Supreme.
41. Rezulton që parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që i ka në dispozicion në bazë të ligjit të aplikueshëm, siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 (2) të Ligjit.
42. Sa i përket procedurave ndaj Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit dhe procedurave ndaj Postës dhe Telekomunikacionit në Pejë, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ka dështuar të provojë se cilat të drejta dhe në çfarë mënyrë vendimet përkatëse të këtyre organeve publike i kanë shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë.
43. Rrjedhimisht, rezulton që kërkesa në tërësi është qartazi e pabazuar në bazë të rregullit 36 (1.c) të Rregullores së punës që parasheh: “(1) Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse: c) kërkesa është qartazi e bazuar.”
44. Për arsyet e lartpërmendura kërkesa është e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 (2) të Ligjit si dhe rregullat 36 (1.c) dhe 56 (2) të Rregullores së punës, më 29 nëntor 2011, njëzëri

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t’u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Snezhana Botusharova

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. Dr. Enver Hasani